



GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		06/10/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/04	44	110

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas



PROCESVERBAL

I

DËGJIMEVE BUXHETORE

Vendi: SHFMU “Abedin Bujuqi”, Arllat

Datë: 19.08.2025

Ora: 19:15

Dëgjimet buxhetore në Arllat u mbajtën më 19 gusht 2025, ku morën pjesë përfaqësues nga fshatrat Arllat, Gjergjicë, Negroç, Llapushnik, Bytyq dhe Vuçak. Në këtë dëgjim buxhetor, nga Komuna ishin të pranishëm:

Ramiz Lladrovci	Kryetar i Komunës
Arben Shala	Nënkryetar i Komunës
Muhamet Gjoka	Drejtor i Drejtorisë për Arsim,
Endrit Gllareva	Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Publike
Nexhmedin Gruda	Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, dhe UD i Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Kushtrim Bajraktari	ZKF-Zyrtar Kryesor Financiar
Bekim Dobra	Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun

Rendi i ditës

Dëgjimi Buxhetor filloi me këtë rend dite:

1. Prezantimi i projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028,
2. Pranim dhe shqyrtimi i kërkesave,
3. Çështje të ndryshme.

Hyrje

Prezantimi i projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028

Hapjen e dëgjimit buxhetor e bëri Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, z. **Bekim Dobra**. Në fjalën e tij hyrëse, ai theksoi rëndësinë e organizimit të dëgjimeve buxhetore si mekanizëm i transparencës dhe i përfshirjes së qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor. Po ashtu, ai prezantoi rregullat dhe procedurat që do të ndiqeshin gjatë zhvillimit të këtij dëgjimi.

Tutje, fjalën e mori **Kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci**, i cili përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen aktive në këtë proces. Ai theksoi se dëgjimi ka për qëllim shpalosjen e projeksioneve buxhetore për vitet 2026–2028, si dhe mbledhjen e kërkesave e propozimeve nga qytetarët për projektet e nevojshme në komunitet.

Kërkesat

Pranim dhe shqyrtimi i kërkesave

Pas fjalës përshëndetëse të Kryetarit Lladrovci, fjalën e morën përfaqësuesit e fshatrave të këtyre lokaliteteve, të cilët parashtruan kërkesat e tyre.

Përfaqësuesit e fshatrave paraqitën kërkesat e tyre. Në total u parashtruan tri kërkesa kryesore: Ndriçim publik, Infrastrukturë rrugore, Ujësjellës dhe kanalizim.

Kërkesat u pranuan dhe u regjistruan, ndërsa u dhanë përgjigje të përgjithshme nga kryetari i komunës dhe drejtorët përkatës.

Tabela e kërkesave dhe përgjigjeve

Përfaqësues / Banor	Lokaliteti	Kërkesa	Përgjigja / Sqarimi nga institucioni
Burim Bujupi	Fshati Arllat	122 mijë euro janë të parashikuara për fusha sportive në Korroticë, Komoran dhe Arllat. Kërkesë për renovim të fushave sportive.	Endrit Gillareva: Shpjegim: Kodi i Drejtorisë së Kulturës parasheh buxhet për fusha sportive.
Urim Gashi	Lagja Gashi, Arllat	Shumica e kërkesave të bëra më herët janë realizuar. Kërkesë për ndriçim publik në një rrugë ku nuk ka shtylla betoni – të gjendet një zgjidhje alternative. Ura e vendit ka nevojë të rrethohet për shkak të rrezikut për fëmijët (thellësi e madhe). Kërkesë nga banorët për një park të vogël pranë kroit, si vend pushimi për qytetarët.	Faleminderit për bashkëpunimin dhe për angazhimin e vazhdueshëm të qytetarëve. Shumica e kërkesave të paraqitura më herët janë realizuar, ndërsa për kërkesat e reja janë marrë në shqyrtim hapat për zbatim. Sa i përket ndriçimit publik në rrugën pa shtylla betoni, komuna do të shqyrtojë një zgjidhje alternative teknike për vendosjen e ndriçimit në atë segment. Ura e vendit do të rrethohet për të shmangur çdo rrezik, veçanërisht për fëmijët, ndërsa kërkesa për ndërtimin e një parku të vogël pranë kroit do të shiqohet mundësia për t'u përfshirë në planin e investimeve në hapësirat publike rekreative.

Çështje të ndryshme

Nuk pati pika shtesë për diskutim.

Përfundimi

Meqenëse rendi i ditës u përmbyll, dëgjimi buxhetor u shpall i përfunduar.

Kryetari falënderoi pjesëmarrësit për kontributin e tyre.

Numri i Pjesëmarrësve		
M - 22	F – 2	Totali: 24

Procesmbajtësi

Avdyl Mziu

